



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

OSNOVNI SUD GNJILANE

---

Numri i lëndës: 2022:228287  
Datë: 25.01.2023  
Numri i dokumentit: 03902812

**CP. nr.995/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Milorad Mitković, me bashkëpunatorin profesional Baki Sylejmani, në lëndën përmbartimore të kreditorit R.I.nga Gj., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kaqusha Avdiu-Sylejmani avokate nga Gjilani, kundër debitores Komuna Gjilan-DKA Gjilan, lidhur me kompensimin e shpenzimeve për ushqim dhe shpërblim jubilar, jashtë seancës gjyqësore në kuptim të nenit 152 të Ligjit për procedurën përmbartimore-në tekstin e mëtejme LPP-së, më datën 23.01.2023, jashtë seance merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Urdhërohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave-Thesari në Prishtinë, që mjetet monetare nga xhiro-llogaria e debitores Komuna Gjilan-DKA Gjilan, dhe atë në emër të shpenzimeve të shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e ushqimit shumë prej 1,916.65€ (së bashku me kamtën ligjore), në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, shumë prej 507€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 2,423.65€ (dymijë e katërqind e njëzetë e tre euro e gjashtëdhjetë e pesë cent), të bartet në emër të përfaqësueses së kreditorit Kaqusha Avdiu-Sylejmani avokate nga Gjilani, në xhiro-llogarinë me nr.1401000000822254, pranë Bankës Ekonomike – Dega në Gjilan, pasi që aktvendimi mbi caktimin e përmbartimit CP.995/2022 i datës 07.11.2022, është bërë i ekzekutueshëm më datën 21.11.2022 në kuptim të nenit 152 të LPP-re.

II. Aktvendimi në dispozitivin I. e ka efektin e aktvendimit për përmbartim me të cilin është caktuar sekuestrimi i kredisë në të holla të debitores dhe kalimin e saj për arkëtim në dobi të kreditorit në kuptim të nenit 152 të LPP-re.

III. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

IV. Aktvendimi t'i dorëzohet palëve ndërgjyqësore, si dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave – Thesarit në Prishtinë kurse një ekzemplarë të ruhet për dosje.

## A r s y e t i m

Përfaqësuesja e kreditorit Kaqusha Avdiu-Sylejmani avokate nga Gjilani, më datën 01.11.2022, ka ushtruar propozim për përmbarrim kundër debitorës Komuna Gjilan-DKA Gjilan, lidhur me pagesën e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar në bazë të aktgjykimit Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.507/20 të datës 25 Maj 2021, së bashku me shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarrimore në shumë totale prej prej 2,036.75€.

Duke vepruar sipas këtij propozimi, gjykata ka lejuar të njëjtin dhe një kopje i ka dërguar debitorës, dhe kjo e fundit në afatin ligjor nuk ka paraqitur kundërshtim dhe më pas gjykata ka caktuar ekspertin financiar, për të llogaritur kamatën ligjore.

Me datë 13.12.2022, gjykata ka pranuar ekspertizën financiare, ku eksperti për periudhën prej 08.04.2020 e deri me 07.12.2022, për shumën e aprovuar prej 1,579.75€, kamatën prej 8 %, ka paraqitur shumën prej 336.90€. Ekspertizës financiare gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që eksperti në fjalë (Ibrahim Tahiri) ka një përvojë të gjatë në përpilimin e konstatimeve të tija.

Sa i përket shpenzimeve Gjykata llogariti shumën prej 507€ edhe atë: në emër të procedurës kontestimore shumën prej 270€ (si pas aktgjykimit i cili përmbarron) shumën prej 156€ për shpenzimet të procedurës përmbarrimore, për taksë për përmbarrim shumën prej 31€ si dhe në emër të Ekspertizës shumën prej 50, pasi që debitorja nuk ka paguar në afatin e paraparë kreditorit dhe këto shpenzime janë krijuar pa vullnetin e këti të fundit .

Pasi që aktvendimi mbi caktimin e përmbarrimit lëndor është i formës së prerë më datën 24.11.2022, në kuptim të nenit 152 LPP-së si dhe nenit 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi nr.03/L-048 janë plotësuar kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e trajtuar aktvendimin në dispozitivin I. si aktvendim me të cilin është caktuar sekuestrimi i kredisë në shumën monetare lëndore të debitorës në fjalë dhe kalimin e saj për arkëtim në dobi të kreditorit në fjalë si dhe nenit 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, sepse në kuptim të dispozitës së nenit 12 parag. 2 të LPP-re me dispozitat e nenit 144-156 nuk është paraparë paraqitja e ankesës kundër aktvendimit me të cilin urdhërohet banka ose ndonjë institucion tjetër përkatës siç kemi të bëjmë me rastin konkret në dispozitat e nenit 152 të LPP-re, përkitazi me përmbarrimin për kredinë sipas llogarisë në bankë. Arkëtimi lëndor i kredisë në të holla nga ana e subjekteve të caktuara siç kemi të bëjmë me rastin konkret është rregulluar me nenin 40 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi nr. 03/L-048.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil**

**CP.995/2022, më datën 23.01.2023**

**Gjyqtari**  
Milorad Mitković

**KËSHILLË JURIDIKE** - Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.